



ANALIZË TEMATIKE

NDIKIMI EKONOMIK I COVID-19 NË KOSOVË

Korrik 2020

RRETH ANALIZËS TEMATIKE

Analiza Tematike është një publikim i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) i cili synon të sjellë vëmendje tek politikat e ndryshme ekonomike dhe të përshkruajë sfidat për zhvillimin e politikave të tilla, në mënyrë që të hapë rrugë për adresimin e tyre. Ky botim vë fokusin në Reagimin Ekonomik Botëror ndaj pandemisë COVID-19. Ju lutemi keni parasysh se kjo analizë pasqyron perspektivën e Marsit 2020 dhe meqenëse virusi po evoluon shpejt, disa informacione mund të jenë të vjetruara.

Shënim: Kjo analizë është përpiluar fillimisht në gjuhën angleze.

HYRJE

Ngjarja e vitit 2020 që shpesh po quhet mjellma e zezë, gjegjësisht pandemia COVID-19 ka rënduar shumë ekonominë botërore, përfshirë atë të Kosovës. Përballë një katastrofe të mundshme shëndetësore, qeveria e Kosovës ngjashëm si qeveritë e vendeve të tjera filloj zbatimin e masave të rrepta të kontrollit të cilat kanë ngrirë një pjesë të madhe të ekonomisë së vendit. Nga marsi deri në maj, vendi ka qenë i bllokuar pothuajse totalisht, ku aktivitetet e jashtme kanë qenë rreptësisht të ndaluara. Ndërsa ndërmarrjet hasën në vështirësi të mëdha për të operuar dhe ofruar shërbime, numri i punëkërkesve në vend u rrit shumë më shumë sesa në të kaluarën. Kriza e rritur ekonomike parashikohet se do të shkaktojë probleme deri në TM1 të vitit 2021, e kjo do të thellojë më tej deficitin tregtar, kryesisht për shkak të rënies së vëllimit të remitancave dhe turizmit të diasporës.

Kjo analizë tematike synon të ofrojë të dhëna dhe informacione paraprake mbi ndikimin aktual të pandemisë në aspektin ekonomik të Kosovës, ashtu siç parashikohet nga institucionet financiare ndërkombëtare, gjendja e mbledhjes së të hyrave nga Administrata Tatimore në Kosovë (ATK), si dhe studime të kryera nga shoqatat e biznesit dhe organizatat joqeveritare në vend.

NDIKIMI I KORONAVIRUST DERI SOT DHE PARASHIKIMET PËR TË ARDHMËN

Para shpërthimit të pandemisë COVID-19, parashikimet për ekonominë e Kosovës për vitin 2020 ishin premtuese. Vlerësimet e bëra nga Grupi i Bankës Botërore (GBB), parashihnin rritje prej 4% të Bruto Produktit Vendor (BPV) në vitin 2020.¹ Sidoqoftë, marrë parasysh rrethanat dhe kushtet që po ndryshojnë me shpejtësi të madhe si shkak i kufizimeve të COVID-19, ngritja ekonomike tani është minuar dhe rreziku i tkurrjes ekonomike mbetet i lartë. Ngjashëm me ekonomitë e tjera në zhvillim, virusi pritet të ketë ndikim negativ tronditës edhe në tregun e brishtë të Kosovës.


Pasiguria e madhe në lidhje me jetëgjatësinë dhe nivelin e ashpërsisë së virusit ka shtyrë vendin të marrë masa strikte, përfshirë kufizimet në lëvizjen e njerëzve, shërbimeve dhe mallrave, ndalimin e udhëtimeve,

¹ GBB, Ndikimi Ekonomik dhe Social i COVID-19, Shënime për Shtetet, Pranverë, 2020, marrë nga <http://documents.worldbank.org/curated/en/457181588085856454/pdf/The-Economic-and-Social-Impact-of-COVID-19-The-Country-Notes.pdf>

pezullimin e procesit arsimor, mbylljen e bizneseve jo-esenciale dhe më vonë edhe imponimin e izolimit të pjesshëm të popullsisë.

Gjersa masat kufizuese mund të kenë pasur ndikim pozitiv në frenimin e përhapjes së virusit, dhe në parandalimin e përshkallëzimit të krizës shëndetësore, efekti dhe pasojat nga mbyllja e ekonomisë për javë të tëra mund të jetë i rëndë. Një studim i kryer nga Oda Amerikane në bashkëpunim me katër organizata tjera përfaqësuese të bizneseve gjatë tre javëve të para të pandemisë, me qëllim të matjes së ndikimit të COVID-19 në aktivitetet e kompanive anëtare ka treguar rezultate shqetësuese. Në bazë të anketës, kriza e shkaktuar nga COVID-19 ka ndikuar thellë në aftësinë e sektorit privat për të operuar, ku 39% të ndërmarrjeve të anketuara janë mbyllur plotësisht, 30.7% kanë punuar me kapacitete të reduktuara dhe 13.8% kanë funksionuar me orare të reduktuara të punës. Në të njëjtën kohë, 60% e të anketuarve besonin se kriza COVID-19 rrezikon mbijetesën e biznesit të tyre.² Ndërmarrjet raportuan humbjet financiare (77.78%) dhe mungesën e likuiditetit (43,72%) si shqetësimet e tyre kryesore, pasuar nga mungesa e efikasitetit në punë (39,37%), dhe kapacitetet prodhuese (26.81%).³ Jo-çuditërisht, tregtia me shumicë (74,42%) dhe pakicë (76.04%) raportohet të kenë pësuar humbjet më të mëdha financiare, kjo pasi kërkesa e konsumatorëve ka rënë (shih fig. 1).

Figura 1




Burimi: Të dhënat nga ATK. Kalkulimet: Oda Amerikane

² Oda Amerikane, Oda Ekonomike e Kosovës, Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare, Klubi i Prodhuesve të Kosovës, Këshilli i Investitorëve Evropian, Ndikimi i COVID-19 në Ndërmarrjet në Kosovë, Prill, 2020, marrë nga <https://www.amchamksv.org/wp-content/uploads/2020/04/Study-on-the-impact-of-COVID-19-on-Kosovo-Businesses.pdf>

³ Ibid.

Figura 2



Burimi: Të dhënat nga ATK. Kalkulimet: Oda Amerikane

Megjithëse shkalla e rënies ekonomike ende nuk mund të vlerësohet dhe kuantifikohet plotësisht, për shkak të pasigurive në rritje dhe ngjarjeve fluide, disa vlerësime tashmë janë bërë. Sipas raportit të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), BPV e Kosovës pritet të zvogëlohet me 5% në vitin 2020, pasuar me rritje prej 7.5% në 2021.⁴ Të ardhurat fiskale pritet të ulen deri më 12% në vitin 2020, marrë parasysh rënien e papritur të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) dhe të detyrimeve doganore. FMN gjithashtu ka parashikuar që faturat e turizmit parashikohet të ulen me rreth 20% në vitin 2020, pasi udhëtimet e diasporës mund të ndalen në TM2 për shkak të kufizimeve të udhëtimit, duke shkaktuar kështu humbje të mëdha në industrinë e mikpritjes.⁵ Sidoqoftë, marrë parasysh faktin se kufizimet e udhëtimit është njoftuar se do të hiqen plotësisht në Kosovë, atëherë shërbimet e udhëtimit mund të rifillojnë nga fundi i qershorit dhe fillimi i korrikut, prandaj ky parashikim mund të mos qëndrojë më. Për më tepër, FMN gjithashtu vlerësoi se eksportet e mallrave do të ulen për 17% për shkak të recesionit global, pasi shitjet e huaja të Kosovës përbëhen kryesisht nga metalet. Përveç kësaj, remitancat që përbëjnë rreth 15% të BPV-së parashikohet të bien deri më 10% në vitin 2020, si pasojë e efekteve të pandemisë në vendet me origjinë. Në të njëjtën kohë, Investimet e Huaja Direkte (IHD) dhe flukset e tjera financiare pritet të ulen përgjysmë, në 3.6% të BPV-së në vitin 2020.⁶

Një pamje më pak dekurajuese është parashikuar nga GBB-ja në skenarin e saj fillestar, ku pritet që BPV të zvogëlohet deri në 4.5% në vitin 2020, ndjekur nga një rritje në vitin 2021. Eksportet në tërësi pritet të zbrasin 3.4 pikë përqindje nga rritja, jo vetëm për shkak të shërbimeve më të ulëta të eksporteve, por edhe për shkak të një rënie të parashikuar të çmimeve të nikelit. GBB gjithashtu pret

⁴ FMN, Raporti i Parashikimit të Ekonomisë Botërore: Izolimi i Madh, Prill, 2020, marrë nga <https://www.imf.org/en/Publications/WEO/Issues/2020/04/14/weo-april-2020>

⁵ FMN, Komunikatë nga Drejtori Ekzekutiv për Republikën e Kosovës, Prill, 2020, marrë nga <https://www.imf.org/en/Publications/CR/Issues/2020/04/16/Republic-of-Kosovo-Request-for-Purchase-Under-the-Rapid-Financing-Instrument-Press-Release-49339>

⁶ Ibid.

që investimet private të bien për shkak të pasigurisë dhe kufizimeve të parave që masat e kontrollit janë duke ju shkaktuar ndërmarrjeve, si dhe gjithashtu parasheh rënie në IHD të patundshmërisë. Për më tepër, konsumi privat parashikohet të rrëshqasë vetëm pak, me vetëm 0.2%, por konsumi i qeverisë pritet të rritet ndjeshëm bazuar në buxhet, edhe për shkak të reagimit të nevojshëm ndaj COVID-19. Tutje, GBB vlerësoi se investimet publike të financuara nga buxheti i shtetit mund të bien për shkak të hapësirës së kufizuar fiskale që të reagoj ndaj shpërthimit të pandemisë. Krejt në fund, disa projekte të mëdha investimesh publike që pritej të realizoheshin, veçanërisht projektet hekurudhore dhe rrugore të financuara nga institucionet financiare ndërkombëtare, gjithashtu mund të shtyhen për më vonë.⁷

Në skenarin e saj negativ GBB parashikon recesion të thellë në Kosovë, i cili supozon se kufizimet nuk do largohen deri në TM3 të vitit 2020. Në këtë skenar, eksportet pritet të ulen deri në 25.5%, kryesisht për shkak të rënies nominale të pjerrët të eksporteve të shërbimeve (25.9 %) dhe mallrave (18.6%).⁸ IHD neto priten të ulen deri më -8.3% për shkak të të hyrave më të vogla në patundshmëri dhe investime më të vogla nga fitimet që ndodhin si rezultat i profitit të ulët. Investimet, si publike ashtu edhe private, pritet të pengohen nga pasiguria e shumta, kufizimet në financa, dhe hapësira e kufizuar fiskale. Konsumi privat gjithashtu pritet të bie më shumë nga rritja për shkak të uljes së punësimit dhe të ardhurave të disponueshme. Në anën tjetër, remitancat e pranuar nga kanalet joformale dhe IHD-të pritet të zvogëlohen, duke e bërë më të vështirë financimin e deficitit të llogarisë korente.⁹ Për Kosovën, vlerësohet se remitancat do të zbrasin nga 0.8 në 1.1% të BPV-së.¹⁰ Të gjitha këto zhvillime pritet të tkurrin rritjen ekonomike të vendit gjatë vitit 2020.

Rënia ekonomike në Kosovë ka sfiduar gjithashtu edhe mbledhjen e të hyrave. Sipas të dhënave të ATK-së, në pesë muajt e parë mbledhja e të hyrave ra thellësisht, ku nga janari deri në muajin maj të 2020 janë mbledhur vetëm 184 milion euro, pra 25 milion euro më pak krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Është e rëndësishme të theksohet se të hyrat u rritën para se pandemia të godiste ekonominë e Kosovës, ku nga janari deri në shkurt të vitit 2020, ATK ka pasur rritje të të hyrave prej më shumë se 10%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 (shih fig. 4). Sidoqoftë, ulja në mbledhjen e tatimeve në pesë muajt e parë të vitit 2020 nuk është befasi, marrë parasysh vendimet e qeverisë ku kjo e fundit ka shtyrë afatin e deklarimit të pagesave dhe obligimeve tatimore fillimisht deri më 30 prill dhe më vonë deri më 30 qershor 2020. Megjithatë, rënia e mprehtë e të ardhurave nga tatimet mund të paraqesë probleme për buxhetin e shtetit.

Rënia e të hyrave nga tatimet lidhet gjithashtu drejtpërdrejt me rënien e qarkullimit të bizneseve. Siç shpjegohet në figurën 3, nga fundi i marsit deri në maj të vitit 2020, bizneset kanë pësuar rënie të

⁷ GBB, Ndikimi Ekonomik dhe Social i COVID-19, Shënime për Shtetet, Pranverë, 2020, marrë nga <http://documents.worldbank.org/curated/en/457181588085856454/pdf/The-Economic-and-Social-Impact-of-COVID-19-The-Country-Notes.pdf>

⁸ Ibid.


⁹ Ibid.

¹⁰ GBB, Ndikimi Ekonomik dhe Social i COVID-19, Sektorët e Jashtëm, Pranverë, 2020, marrë nga <http://documents.worldbank.org/curated/en/322141591283636250/pdf/External-Sector.pdf>

mëdha të qarkullimit në krahasim me të njëjtën periudhë në vitin 2019. Përfaqësuesit e ATK-së kanë deklaruar publikisht që nuk do të mund t'i arrijnë objektivat fiskale të parashikuara për vitin 2020.


Meqenëse nevojitet më shumë hapësirë fiskale për t'u marrë me efektet e pandemisë COVID-19, javën e dytë të qershorit Parlamenti i Kosovës miratoi propozimin e Qeverisë për të tejkaluar përkohësisht rregullat e deficitit fiskal.

Figura 3



Burimi: Të dhënat nga ATK. Kalkulimet: Oda Amerikane

Figura 4



Burimi: Të dhënat nga ATK. Kalkulimet: Oda Amerikane

Në çfarëdo mënyre, mbetet e vështirë të vlerësohet ndikimi i mundshëm fiskal i pandemisë në këtë kohë, por shenjat e hershme nuk janë inkurajuese. Rënia e madhe e mundshme e të hyrave kombinuar me stimujt fiskal pritet të zgjerojnë deficitin buxhetor në vitin 2020. Bazuar në vlerësimet e bëra nga GBB, të hyrat parashikohen të bien në 11% për shkak të ngadalësimit të aktivitetit ekonomik dhe masave për shtyrje të deklarimeve tatimore. Përveç kësaj, GBB theksoi se deficitin fiskal është vlerësuar se do të arrijë në 6.3% të BPV-së, përkundër rënies së shpenzimeve kapitale në 43.5%, nxitur

si nga rënia e të hyrave ashtu edhe nga paketa e stimuljeve qeveritar, që vlerësohet se do të kushtojë rreth 2.8% të BPV-së.¹¹ Në vitin 2020, shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor do të kenë mungesa të mëdha në të hyrat publike. Krahasuar me vitin 2019, të ardhurat parashikohet të bien deri në më shumë se 10% në Kosovë, ndërsa mund të bien edhe më shumë nëse masat kufizuese vazhdojnë edhe në tremujorin e dytë të vitit.¹²

NUMRI I PUNËKËRKUESVE ËSHTË RRITUR

Rënia e papritur e aktiviteteve të punës ka goditur sektorë të ndryshëm të ekonomisë në mënyra të ndryshme, ndërsa ndikimi në vendet e punës mund të jetë i madh. Si rezultat i mbylljes së bizneseve jo-esenciale, një numër i konsiderueshëm i punëtorëve humbën vendet e tyre të punës. Kështu, kjo ka çuar në një rritje befasuese të numrit të qytetarëve të regjistruar si të papunë në zyrat e punës. Një analizë e fundit e realizuar nga Instituti GAP tregon se vetëm në prill të vitit 2020, Agjencia e Punësimit dhe 34 zyrat e saj lokale regjistruan gjithsej 32.377 punëkërkues të rinj. Kjo ka rritur numrin e punëkërkuesve të regjistruar në 37,392 për periudhën janar-prill 2020.¹³

Instituti GAP gjithashtu theksoi se ndërsa në mars të vitit 2019 tregtia me shumicë dhe pakicë punësoi rreth 80 mijë punëtorë, në mars 2020 ky numër ra në rreth 43 mijë. Ulje të numrit të punëtorëve ka pasur edhe në industrinë e ndërtimit, ku në të njëjtën periudhë krahasuese numri ra nga 21 mijë në vetëm 10 mijë, si dhe në industrinë përpunuese ku pati një ulje nga rreth 34 mijë në 22 mijë. Më saktësisht, që nga muaji mars, numri i punëkërkuesve është rritur në 31,550. Kjo bëri që numri i përgjithshëm i punëkërkuesve në Agjencinë e Punësimit të arrinte shifrën e 37,392 deri në prill të vitit 2020, një rritje shumë e madhe krahasuar me periudhën e fundit katër-mujore të vitit 2019 kur numri i punëkërkuesve ishte vetëm 6,882.¹⁴ Ulja e numrit të punëtorëve në tregti me shumicë dhe pakicë dhe në ndërtimtari nuk është befasi, marrë parasysh se këto industri kanë qarkullimin më të lartë, si dhe kanë përjetuar humbjet më të mëdha financiare gjatë këtyre kohërave, siç edhe shpjegohet në fig. 1.

Për më tepër, bazuar në anketën e bërë nga Oda Amerikane bashkë me organizatat e tjera të biznesit, 10% e ndërmarrjeve të mëdha deklaruan se kanë zvogëluar 30% të fuqisë punëtore. Ulje në numrin e punëtorëve kanë pasur më së shumti ndërmarrjet mikro dhe të vogla, ku 8.5% e ndërmarrjeve mikro kanë ulur 30-50% të fuqisë së tyre punëtore, ndërsa 13.9% kanë ulur mbi 50% të fuqisë punëtore.

¹¹ GBB, Ndikimi Ekonomik dhe Social i COVID-19, Shënime për Shtetet, Pranverë, 2020, marrë nga <http://documents.worldbank.org/curated/en/457181588085856454/pdf/The-Economic-and-Social-Impact-of-COVID-19-The-Country-Notes.pdf>

¹² GBB, Ndikimi Ekonomik dhe Social i COVID-19, Politikat Fiskale, Pranverë, 2020, marrë nga <http://documents.worldbank.org/curated/en/117501591288273884/pdf/The-Economic-and-Social-Impact-of-COVID-19-Fiscal-Policy.pdf>

¹³ Instituti GAP, Ndikimi i Pandemisë COVID-19 në Tregun e Punës, Qershor, 2020, marrë nga https://www.institutigap.org/documents/28751_covid_labor%20market.pdf

¹⁴ Ibid.

Ngjashëm, 5% e ndërmarrjeve të vogla kanë ulur 30-50% të fuqisë punëtore, ndërsa 7.5% kanë reduktuar rreth 50% të fuqisë së tyre të punëtore. ¹⁵

Ndikimi i plotë në punësim ende mbetet të shihet, megjithatë, tkurrja e forcës punëtore mund të shkaktojë gjithashtu goditje të kërkesës për shkak të paftësisë për t'ju përgjigjur kërkesave të konsumatorëve për mallra dhe shërbime. Në kohën kur po shkruhet kjo analizë, shumë punëtorë janë kthyer përsëri në punë, por pasiguria tashmë e rritur rreth vendeve të punës ka shtyrë konsumatorët që të ndalin shpenzimet, e nëse trendi vazhdon, kjo mund të pengojë më tutje rikuperimin ekonomik.

HAPJA GRADUALE E EKONOMISË

Ekonomia e Kosovës u hap gradualisht, ndërsa bizneset duhej t'i përmbaheshin një sërë masash parandaluese para se të fillonin aktivitetet e tyre. Rifillimi i aktiviteteve ekonomike filloi për industri të ndryshme në kohë të ndryshme, ku vala e parë e masave kufizuese filloi nga 4 maji, valë kjo që lejonte aktivitetet e ndërtimtarisë, patundshmërisë, shitjen e automjeteve motorike, shërbimet e konsulencës dhe shitësit me pakicë. Vala e dytë e relaksimit të masave ka filluar më 18 maj ku ndërmarrjeve shtesë u është lejuar të rifillojnë aktivitetet e tyre përfshirë; dentistët dhe fizioterapistët, parukierët dhe sallonet e flokëve, tregun e gjelbër, restaurantet (merr me vete), qendrat e thirrjeve, muzetë, si dhe rrjetin e transportit urban dhe ndër-urban. Që nga 1 qershori, pothuajse të gjithë sektorët kanë filluar të operojnë, përfshirë; gastronominë, shërbimet e taksive, kinematë dhe teatrot, si dhe hapjen selektive të aktiviteteve sportive. Që nga 8 qershori, të gjitha kufizimet e lëvizjes janë larguar dhe gjithashtu janë hapur kufinj të vendet e rajonit.

Me lehtësimin e masave kufizuese, numri i të infektuarve është rritur përsëri në Kosovë, e nëse ky trend negativ do të vazhdojë, mbetet të shihet. Sidoqoftë, autoritetet shëndetësore kanë paralajmëruar se nëse numri i rasteve rritet, atëherë masat kufizuese mund të vihen përsëri. Në kohën kur po shkruhet kjo analizë, parashikimet mbeten të paqarta.

REAGIMI EKONOMIK I QEVERISË DERI SOT

Deri më tani, Kosova ka arritur të mbajë numrin e vdekjeve të ulët, megjithatë, e njëjta gjë nuk mund të thuhet edhe për shëndetin e ekonomisë. Reagimi ekonomik i Kosovës ndaj COVID-19 nuk ka qenë shumë në kohë, dhe masat e marra për të ndihmuar komunitetin e biznesit si dhe punëtorët që të përballen me krizën e COVID-19 gjatë këtyre kohërave të vështira kanë qenë goxha modeste. Në fakt, masat lehtësuese të marra nga qeveria e mëparshme synonin më së shumti të ofronin ndihmë për grupet më të ndjeshme, duke drejtuar kështu ndihmën financiare më shumë si ndihmë sociale, sesa si mbështetje ndaj biznesit, gjë që nuk ka ndodhur në shumicën e vendeve të tjera.

¹⁵ Oda Amerikane, Oda Ekonomike e Kosovës, Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare, Klubi i Prodhuesve të Kosovës, Ndikimi i COVID-19 në Ndërmarrjen në Kosovë, Prill, 2020, marrë nga <https://www.amchamksv.org/wp-content/uploads/2020/04/Study-on-the-impact-of-COVID-19-on-Kosovo-Businesses.pdf>

Kostoja e të ashtuquajturës Pako Emergjente Fiskale u vlerësua të jetë rreth 180 milion euro. Për më tepër, komunat bazuar në kapacitetet e tyre kanë ofruar një lloj ndihme financiare për sektorët ekonomik më të goditur, për shembull; Komuna e Prishtinës së fundmi ka aprovuar vendimin me anë të së cilit janë siguruar 5 milion euro ndihmë financiare për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM). Vlen të theksohet se deri sot, pako nuk është zbatuar në tërësi.

Përkrahja ndaj Punësimit

Të vetëdijshëm për ndikimin në punësim që ka shkaktuar vendimi për mbylljen e bizneseve, si dhe në përpjekje për të ndihmuar ndërmarrjet të ballafaqohen me krizën, qeveria e mëparshme ofroi stimuj fiskal dhe financiar për të zbutur rënien ekonomike.

Bizneset e kualifikuara kanë pranuar nga 170 euro në muaj për secilin punonjës gjatë marsit dhe prillit. Për më tepër, pakoja kishte paraparë që bizneset të pranojnë nga 206 euro për secilin punonjës të ri të punësuar gjatë krizës e të cilit i ofrohet kontratë të paktën një vjeçare, kjo masë po ashtu synonte të luftojë edhe ekonominë jo-formale. Punëtorët në frontin e parë, si mjekët, policët, dhe zjarrfikësit, pranuan nga 300 euro në muaj gjatë krizës. Po ashtu, punëtorët që punonin në farmaci, dyqane ushqimore apo në biznese të tjera të kategorizuara si esenciale pranuan nga 100 euro në muaj.¹⁶ Krejt në fund, në Pakon Emergjente Fiskale gjithashtu u parapa që gjatë muajve prill dhe maj të sigurohet subvencionimi i qirasë deri në 50% për NVM-të në vështirësi financiare.

Politikat Tatimore

Sa i përket politikave tatimore, Ministria e Financave dhe Transfereve (MFT) në koordinim me ATK-në ka zgjatur afatin për deklarimin dhe pagesat e detyrimeve tatimore, si dhe detyrimet dhe kontributet e pensioneve deri më 30 qershor 2020. Një masë tjetër e përkohshme në lidhje me tatimet ishte heqja e TVSH-së në importe të grurit dhe miellit, si dhe zgjatja e afatit të pagesave të shërbimeve publike deri në fund të prillit. Krejt në fund, më 18 maj, MFT morri edhe një vendim tjetër ku njoftoi se interesi për tatimet e pronave do të pezullohet deri në vitin 2021.¹⁷

Bankimi dhe Financat

Për të ju ndihmuar ndërmarrjeve të sigurojnë likuiditet të mjaftueshëm, Banka Qendrore e Kosovës (BQK) në koordinim me Shoqatën e Bankave të Kosovës vendosën që të shtyjnë afatin për pagesa të kredive deri në 30 prill, e më vonë ky afat u zgjatet deri në mes të qershorit – kjo masë synonte të ju ndihmonte bizneseve dhe familjeve që kanë hasur vështirësi në gjenerimin e të ardhurave si dhe atyre që janë prekur nga kriza.¹⁸ BQK-ja gjithashtu ka deklaruar se pasi të aprovohen kërkesat për shtyrje të kredive nga ana e bankave, asnjë provizion shtesë nuk duhet të aplikohet. Norma e interesit për kreditë e NVM-ve që operojnë në sektorin e turizmit është ulur deri në 50%, ndërsa norma e

¹⁶ OBZHE, Kriza e COVID-19 në Kosovë, Qershor, 2020, marrë nga <https://www.oecd.org/south-east-europe/COVID-19-Crisis-in-Kosovo.pdf>

¹⁷ Ibid.

¹⁸ BQK, Komunikatë nga Guvernatori Mehmeti, Prill, 2020, marrë nga 2020, marrë nga <https://www.bqk-kos.org/?id=104&l=1731>

interesit për kreditë e kompanive të mëdha është ulur deri në 15%.¹⁹ Asnjë politikë monetare nuk ka qenë e mundur të zbatohet në Kosovë, pasi vendi është i “euroizuar”.

Disa nga masat tjera përfshijnë; sigurimin e likuiditetit financiar për ndërmarrjet mikro dhe të vetë-punësuarit, përmes programeve të caktuara të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), në shumë prej 10 mijë euro për periudhë 24 muajsh, ku gjithsej masa parashihet të jetë 15 milion euro; rritja e buxhetit për grante dhe subvencione për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për të rritur prodhimin bujqësor, masa kap shumë prej 5 milion euro; rritja e buxhetit për grante dhe subvencione për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në mënyrë që të shmanget situata e krijuar nga situatë emergjente e shëndetit në aktivitete sportive dhe kulturore, masa kap shumë prej 5 milion euro; si dhe është dhënë edhe mbështetje për eksportuesit, ku kjo masë kap shumë prej 10 milion euro.²⁰

MBËSHTETJA NDËRKOMBËTARE

Për të ndihmuar Kosovën të ballafaqohet me pasojat ekonomike dhe shëndetësore, komuniteti ndërkombëtar ofroi mbështetje financiare të paparë.

BE-ja ka aprovuar një pako ndihmë prej 68 milion euro për ta ndihmuar Kosovën të ballafaqohet me krizën e COVID-19 (ku 5 milion euro janë ofruar menjëherë për sektorin e shëndetësisë dhe 63 milion euro tjera për të ndihmuar në rimëkëmbjen ekonomike dhe sociale);

Në prill të 2020, Komisioni Evropian propozoi të përdoret programi për ndihmë makro-financiare, që kap shumë prej 100 milion euro. Propozimi i Komisionit duhet të miratohet nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli i BE-së;

Përmes “Instrumentit të Shpejtë Financiar”, bordi ekzekutiv i FMN-së ka aprovuar ndihmë financiare prej 56.5 milion dollarë (52 milion euro), që synohet t’i ndihmojë Kosovës të forcojë sistemin shëndetësor dhe të lehtësojë efektet e menjëhershme të pandemisë për bizneset dhe familjet;

Në maj, Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës (CEB) miratoi 35 milion euro për të mbështetur sistemin shëndetësor të Kosovës ndërsa përballet me krizën e COVID-19;

Krejt në fund, GBB aprovoi 46 milion euro ndihmë financiare përmes Shoqatës Ndërkombëtare të Zhvillimit, në mënyrë që të mbështes Kosovën në menaxhimin e krizës së COVID-19 dhe fillimin e procesit të rimëkëmbjes ekonomike.²¹

¹⁹ OBZHE, Kriza e COVID-19 në Kosovë, Qershor, 2020, marrë nga <https://www.oecd.org/south-east-europe/COVID-19-Crisis-in-Kosovo.pdf>

²⁰ Zyra e Kryeministrit, Komunikatë mbi Arovimin e Pakos Emergjente Fiskale, Mars, 2020, marrë nga <https://kryeministri-ks.net/en/approval-of-emergency-fiscal-package/>

²¹ OBZHE, Kriza e COVID-19 në Kosovë, Qershor, 2020, marrë nga <https://www.oecd.org/south-east-europe/COVID-19-Crisis-in-Kosovo.pdf>

MUNDËSITË PAS PËRFUNDIMIT TË KORONËS

Rënia e pashmangshme ekonomike ka ndikuar në humbje të konsiderueshme të vendeve të punës dhe në mbledhjen e të hyrave më të vogla, që do të rrisin nivelin e varfërisë në vend. Në mes të kësaj krize të paprecedentë, Kosova ka një mundësi të paprecedentë që të riformoj strukturën e saj ekonomike dhe të përshpejtojë ndryshimet në çështje të rëndësishme ekonomike dhe sociale, të cilat deri më tani kanë minuar përparimin ekonomik të vendit. Krizat si korona mund të sjellin shumë mundësi për ekonominë e brishtë të Kosovës, prandaj institucionet e vendit duhet të shfrytëzojnë mundësinë dhe të adaptojnë politikat që sjellin ndryshime reale. Në anën tjetër, bizneset duhet t'i lejojnë vetes të riorganizohen duke ndjekur kështu transformimin dixhital.

Padyshim se rruga përpara varet shumë nga masat e guximshme që qeveria do të jetë e gatshme dhe e vullnetshme t'i marrë. Në ekonominë e zhvilluara mirë dhe ato në zhvillim, intervenimi i qeverisë ka qenë mjaft mbresëlënëse, e Kosova duhet të ndjekë të njëjtën rrugë. Aktualisht, plani i qeverisë për rimëkëmbjen ekonomike është shumë ambicioz që kap 1 miliard euro, por nëse qeveria do të jetë në gjendje t'i injektojë këto para në ekonomi apo jo, mbetet ende për t'u parë.

PËRFUNDIM

Është ende e vështirë të parashikohet trajektorja e koronavirusit, së bashku me pasojat e sakta ekonomike që sjell kjo pandemi, mbase kjo varet shumë në atë se sa zgjat kriza si dhe në përhapjen e ndonjë vale tjetër ose jo të pandemisë. Sidoqoftë, ajo që mbetet e qartë është se ndikimi në ekonominë e Kosovës do të jetë shkatërrues, veçanërisht nëse humbet sezoni i verës.

Në mënyrë që të trajtohen sfidat e menjëhershme ekonomike dhe të parandalohet përkeqësimi i mëtejshëm, kërkohet koordinim midis të gjithë palëve, pasi nuk do të jetë e mundur që qeveria të kalojë këtë krizë vetëm e pa bashkëpunim. Kohët sfiduese si kjo thërrasin për udhëheqje të fortë e të qëndrueshme në qeveri, biznes dhe në vetë shoqëri.

Oda Amerikane rithekson se përmirësimi i reformave të të bërit biznes është thelbësorë për të zbrapsur ndikimin negativ ekonomik të shkaktuar nga pandemia, dhe se programi i rimëkëmbjes ekonomike të qeverisë duhet të adresojë dhe zgjidh çështjet që lidhen me kapitalin njerëzor duke zvogëluar boshllëkun e shkathtësive dhe parandalimin e një vale potenciale të "ikjes së trurit" përmirësimin e sundimit të ligjit dhe heqjen e barrierave në lëvizjen e lirë të mallrave, shërbimeve dhe kapitalit, adresimin e kufizimeve financiare, si dhe reformimin e vazhdueshëm të mjedisit të të bërit biznesi, si stimuj për investimet e huaja dhe ato vendase.

LISTA E SHKURTESAVE

ATK – Administrata Tatimore e Kosovës

BQK – Banka Qendrore e Kosovës

BZHKE – Banka Zhvillimore e Këshillit Evropian

BPV – Bruto Produkti Vendor

BE – Bashkimi Evropian

FMN – Fondi Ndërkombëtar Monetar

FKKG – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore

GBB – Grupi i Bankës Botërore

IHD – Investimet e Huaja Direkte

KNF – Korporata Ndërkombëtare Financiare

MFT – Ministria e Financave dhe Transfereve

NVM – Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme

OEAK – Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë

OBZHE – Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik

TVSH – Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

REFERENCAT

Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, Oda Ekonomike e Kosovës, Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare, Klubi i Prodhuesve të Kosovës, Këshilli i Investitorëve Evropian, Anketë mbi Ndikimin e COVID-19 në Ndërmarrjet në Kosovë, Prill, 2020

OZHEB, Kriza e COVID-19 në Kosovë, Qershor, 2020

FMN, Raporti i Parashikimit të Ekonomisë Botërore: Izolimi i Madh, Prill, 2020

FMN, Komunikatë nga Drejtori Ekzekutiv për Republikën e Kosovë, Prill, 2020

GBB, Ndikimi Ekonomik dhe Social i COVID-19, Sektorët e Jashtëm, Pranverë, 2020

GBB, Ndikimi Ekonomik dhe Social i COVID-19, Politikat Fiskale, Pranverë, 2020

GBB, Ndikimi Ekonomik dhe Social i COVID-19, Shënime për Shtetet, Pranverë, 2020

Instituti GAP, Ndikimi i Pandemisë COVID-19 në Tregun e Punës, Qershor, 2020

BQK, Komunikatë nga Guvernatori Mehmeti, Prill, 2020

Zyra e Kryeministrit, Komunikatë rreth Aprovimit të Pakos Emergjente Fiskale, Mars, 2020